



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 16.09.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 14.09.2020 të parashtruar nga Grupi i Operatorëve Ekonomik N.T.Sh.,Marash - Shped Sh.p.k & “Company Zuka Comerc”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sanimi dhe ndërtimi i parqeve”, me Nr. të Prok: 632-20-1237-5-2-1, nxjerr:

V E N D I M

- 1. Refuzohet si** e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Grupit të Operatorëve Ekonomik N.T.Sh.,Marash - Shped Sh.p.k & “Company Zuka Comerc”, e dt. 14.09.2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sanimi dhe ndërtimi i parqeve”, me Nr. të Prok: 632-20-1237-5-2-1, kundër **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, te AK – së, të datës 09.09.2020 të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .
- 2. Vërtetohet NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** të publikuar me datë: 09.09.2020;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Grupi i Operatorëve Ekonomik N.T.Sh.,Marash - Shped Sh.p.k & “Company Zuka Comerc”, me datë 14.09.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sanimi dhe ndërtimi i parqeve”, me Nr. të Prok: 632-20-1237-5-2-1,

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 16.09.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pas rishikimit të dokumenteve, autoriteti Kontraktues, konstaton se Operatori Ekonomik NNSH "Korben" i plotëson të gjitha kushtet e kërkuara në dosjen e tenderit dhe Autoriteti Kontraktues, mbetet pranë vendimit të marrë.

Tenderi juaj është eliminuar për arsye se nuk plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktues

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës